

Kini kujdes nga Nurxhitë

Padyshim, hamdi është vetëm për All-llahun. Atë e falënderojmë, prej Tij kërkojmë ndihmë dhe falje. Kërkojmë mbrojtje tek All-llahu nga epshet dhe veprat tona të këqija. Kë e udhëzon All-llahu, s'ka kush e humb; kë e humb All-llahu, s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj dhe deklaroj se nuk meriton të adhurohet askush përpos All-llahut, që është një, pa shokë, dhe se Muhammedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

“O ju që besuat, kini frikë All-llahun me sinqeritet të vërtetë dhe mos vdisni vetëm se duke qenë muslimanë (besimtarë)!” (Ali-Imran, 102)

“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një vete (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra. Dhe kini frikë All-llahun, me emrin e të cilit përbetoheni, ruajeni farefisën (akraballëkun), se All-llahu është mbikëqyrës mbi ju.” (en-Nisa, 1)

“O ju besimtarë, përmbajuni mësimëve të All-llahut dhe thoni fjalë të drejta. Ai (All-llahu) ju mundëson të bëni vepra të mira, jua shlyen juve mëkatet tuaja, e kush respekton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, ai ka arritur një sukses të madh.” (Ahzab, 70-71)

Më pas, fjalët më të mira janë fjalët e All-llahut, udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhammedit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Punët më të shëmtuara janë gjërat e shpikura. Çdo shpikje është bidat, çdo bidat është humbje dhe çdo humbje dërgon në zjarr të Xhehenemit.

All-llahu azze ve xhel-le në Kur'anin fisnik thotë:

“Përvetësoni atë që ju është zbritur nga Zoti juaj e mos zini miq (përkrahës) pos Tij. Pak po merrni mësim.” (A'raf, 3)

“Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë te All-llahu (te libri i Tij) dhe te i dërguari, po qe se i besoni All-llahut dhe Ditës së Fundit.” (Nisa, 59).

Më pastaj:

Një ndër sektet më të përhapura dhe më me ndikim në Turqi është sekti i Nurxhive.¹ Edhe ky sekt, nga shumica e tyre që ekzistojnë në Turqi, janë prej sekteve sufiste. Nga rrjedhin Nurxhitë, kush është prijësi i tyre, cili është libri më i famshëm i tyre në të cilin bazohen e shumë gjëra të tjera si dhe gabimet e shumta që gjenden në librat e tyre mund t'i gjeni në këtë artikull.

- Një biografi e shkurtër e Said Nursit (shejhu i Nurxhive)

Bediuzzamani² ka lindur më 1293 hixhri në Bitlis të Turqisë. Detyrën e tij të "përtëritjes" (përtëritjes së fesë, sipas tyre, sh.a.) e ka filluar më 1324.³

"Në fillim të shekullit XX, popujt muslimanë përjetuan disfata të mëdha. Përfaqësuesi i Islamit, Perandoria Osmane kishte kohë që ishte shkëputur nga shokët e garës. Muslimanët e ngratë e kaluan kohën vetëm duke e soditur gjendjen. Në një anë shtetet e Evropës përgatisnin projektin se si t'i copëtonin vendet muslimane, nga ana tjetër plani përfshinte edhe se si të mund të zhduknin islamin, me një mjet që të mos ringjallet më kurrë. Qëllimi i Luftës së Parë Botërore, këtë e ka pasë në temën e parë, sepse akoma pa filluar lufta, ka qenë e copëtuar bashkësia e popujve muslimanë. Maroku dhe Algjeria kanë qenë të pushtuara nga ana e francezëve, Libia nga italianët, kurse Egjipti dhe Pakistani nga ana e anglezëve. Iraku dhe Siria artificialisht kanë qenë nën sundimin e Osmanëve. Kurse në të vërtetë ato kishin dalur që më parë nga dora e sundimit Osman. Borxhet e jashtme dhe marrëveshjet e mëparshme që ua kishin lidhur duart osmanlinjve, kishte sjellë të bëhet e të dorëzohet menjëherë. Me gjithë këto dobësi, për të mbrojtur kështjellën e fundit të islamit, trimat, nipërit e osmanlinjve, duke paraqitur të gjitha vlerat, nuk rrëzuan hije ndaj sundimit të gjyshërve të pashoq, sundimi i të cilëve ka zgjatur më se 600 vjet. Por sundimi dhe gjykimi i All-llahut tregonte që mjerisht askujt nuk i mjaftonte sakrificat individuale në kohën kur është nevoja e zotërimit të çelësave të diturisë së shkencave të natyrës, e jo më t'i mjaftonte forca për të shpëtuar atdheun e dikujt. Por vetëm bota fizike nuk mund ta ngopë këtë njeri, të cilit i mbizotërojnë vlerat shpirtërore. Duke lexuar këtë libër edhe vetë do ta shihni se si Allahu (xh.sh.) përsëri me anë të një personi nga ky vend, u ka dhënë këtë pamje shpirtërore".⁴

Ai person, sipas pretendimeve të tyre, ishte Said Nursi.

Said Nursi, në vende të ndryshme të Anadollit (në lindje të Turqisë), kishte filluar me aktivitete të Davetit. Në një periudhë, u dha pas politikës e pastaj e braktisi politikën dhe filloi të merrej me shkrime. Shumicën e shkrimeve i përmbloodhi në një libër të quajtur "Risale-i Nur".

- Disa prej gabimeve të tyre

Nurxhitë pretendojnë se Said Nursi ka qenë *Muxhedid* i asaj kohe. Këtë e pohojnë pasuesit e tij. Një shkrim i tillë është gjetur në faqen e tyre të internetit:

"Të nderuar lexues! Një hadith i Pejgamberit (a.s.m.) thekson se: "All-llahu (xh.sh.) në çdo shekull do t'i dërgojë ummetit (popullit musliman) nga një *muxheddit* (ripërtëritës, reformator)." Për përtëritësin e shekullit të parafundit, studiuesit e kësaj fushe unanimit theksojnë se ai ka qenë dijetari i famshëm Mevlana Halidi Bagdadi, i cili

njëkohësisht përputhet në disa pika me të përtëriturin e shekullit të fundit, Bediuzzaman Said Nursiun. Kështu që:

Mevlana Halidi Bagdadi u lind më 1193 hixhri, Bediuzzamani u lind pikërisht pas njëqind vjetësh, më 1293 hixhri. Mevlana detyrën e tij të përtëritjes e filloi më 1224, Bediuzzamani më 1324. Mevlana, në moshën 20 vjeçare, arriti të dalë në krye të të gjithë dijetarëve të asaj kohe. Po kështu edhe Bediuzzamani, i cili moshën 14 vjeçare mori diplomën e teologjisë dhe filloi të diskutonte në çështjet më të thella".⁵

Vepra e Said Nursit "Risale-i Nur" (Mesazhet e dritës) përbëhet nga 14 vëllime me rreth 6000 faqe.

Ata që e pasojnë verbërisht Said Nursin, pretendojnë se veprat e tij kanë qenë frymëzim hyjnor.

Këtë e dëshmon edhe fjala e një pasuesi të tij:

"Bediuzzamani, me njëqind e tridhjetë fragmente të përmbledhjes së Risale-i Nurit, është ngadhënjimtar i zemrave të lexuesve të tij, e për këtë arsye këto vepra janë një fakt i gjallë dhe plot e përplot janë të mbushura me moral, sinqeritet dhe sakrificë. Thuhet se parathënia është një përmbledhje e librit, por çfarë t'i them asaj që çdo temë e Risale-i Nurit është në gjerësinë e një libri. Ju me një habi të madhe, duke i lexuar librat e tij, do ta shihni vetë se Bediuzzamani, që nga fëmijëria e deri në fund të moshës ka përjetuar afër një shekull, ku vazhdimisht është përballuar me frymëzimet hyjnore. Duke e hulumtuar këtë personalitet të shquar hollësisht, na përkujton një varg të një poeti arab që thotë: "Fuqploti nuk e ka të vështirë t'i përmbledhë edhe botët tek një personalitet..."⁶

Po ashtu një thënie të njëjtë e kemi edhe nga vetë Said Nursi:

"Fshehtësia e vërtetë e Kur'anit po na zbritet nëpërmjet "Risale-i Nurit".⁷

Me këtë thënie të tij, ai veten po e vendos në shkallën e peygamberllëkut. Edhe nëse ai nuk pretendon se është peygamber, thëniet e tija tregojnë qartë.

Pretendojnë se vepra "Risale-i Nur" është prej tefsireve më të mira të Kur'anit. Nëse i japim një vështrim "Risale-i Nur", do të shohim se në shumë gjëra i ka interpretuar dhe ka shtuar fjalë të veta.

Kanë thënë pasuesit e tij për Said Nursin:

"... diturinë dhe shkencën që mësohet për njëzet vjet (Said Nursi, sh.a.) e ka kuptuar dhe plotësuar për tre muaj. Në çfarëdo qoftë shkencë që është pyetur, çdo pyetjeje i është përgjigjur menjëherë, pa hezitim".⁸

Thonë se “ka kërkuar *ilm* nga Pejgamberi, sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem, në ëndërr... Për këtë arsye, gjersa ishte në moshën fëmijërore, u bë i njohur si më i dituri i asaj kohe dhe nuk pyeste askënd, ndërsa u përgjigjej të gjitha pyetjeve që ia bënin”.⁹

Transmetohet nga el-Hajthem Ibn Xhemil ka thënë: “E dëgjova Malikun të pyetej për 48 çështje. Ai u përgjigj për 32 prej tyre duke thënë ‘Nuk e di’”. (Transmetuar nga Ibn Abdul-Berr në *Xhami’ul-Bejanil-Ilm ue Fadlihi* (2/25))

Abdur-Rahman Ibn Mehdi (v.198H), Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Ishim me Malik Ibn Enes kur erdhi një person dhe tha: “O Ebu Abdullah, kam udhëtuar një distancë prej gjashtë muajsh. Njerëzit e vendit tim më dërguan të të pyes për një çështje.” Ai tha: “Pyet!” Kështu, personi e pyeti për disa gjëra, kurse ai u përgjigj: “Nuk e di.” Personi kujtoi se kishte ardhur tek dikush që dinte gjithçka, kështu që i tha: “Çfarë t’u them tani njerëzve të vendit tim kur të kthehem?” Ai tha: “Thuaju që Malik Ibn Enes nuk e dinte.” (Transmetuar nga Ibn Ebi Hatim në *el-Xherh uet-Ta’dil* (1/17))

- Përse e quajnë Said Nursin “Bediuzzaman” (Mrekulli e kohës)?

Pretendojnë se “ky llogar i është dhënë nga njerëzit e ditur të asaj kohe, për shkak të diturisë së jashtëzakonshme (të mbinatyrshme, sh.a.) që vërejtën tek ai.”¹⁰

Said Nursi, në “*Sikkei Tasdiki Gajbi*” (vepra e tij, sh.a.), na tregon në lidhje me thirrjen (kërkimin e ndihmës) që ia ka bërë AbdulKadrit: “*Medet Ja Abdulkadir!*”¹¹ Këtu shihet qartë se Said Nursi kërkon ndihmë nga AbdulKadir Xhejlani, ndërsa dihet fare mirë se AbdulKadir Xhejlani ka vdekur në vitin 561 hixhri.¹² Këtu kemi të bëjmë me shirk në teuhidin uluhije. Thotë All-llahu subhanehu ve teala në suren el-Fatiha:

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej teje kërkojmë ndihmë!”

Në një ajet tjetër, All-llahu subhanehu ve teala thotë:

“Thuaju: “Nëse ju vjen dënimi nga All-llahu ose ju vjen kiameti, më tregoni, nëse jeni të sinqertë, a do të thirrni dikë tjetër pos All-llahut (për ndihmë)? Jo, vetëm Atij (All-llahut) do t’i luteshit. E, nëse do Ai, jua heq atë (shqetësimin) për çka i luteni, e do t’i harroni ata (zota) që ia shoqëroni.” (el-En’Aam, 40-41).

“Ata, pos All-llahut, adhurojnë çdo gjë që nuk bën dobi, e thonë: “Këta janë ndërmjetësuesit tanë te All-llahu!”. Thuaj: “A po e informoni All-llahun me diçka që Ai nuk e di se ç’ka në qiej dhe në tokë?” E pastër është madhëria e Tij nga ajo që i shoqërojnë!” (Junus, 18)

“Pra, përpos All-llahut, mos lut zot tjetër e të bëhesh prej të dënuarve.” (Shuara 213)

“Ata që po i lusin (pos Zotit) vetë kërkojnë afrimin (te Zoti i vërtetë), shpresojnë në mëshirën e Tij dhe i frikësohen dënimit të Tij. Vërtet, dënimit të Zotit tënd është për t’iu ruajtur.” (Isra, 57)

Ka thënë Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: "Nëse lutesh, lute All-llahun. Nëse kërkon ndihmë, kërko nga All-llahu." (Tirmidhiu)

Është pyetur Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: "Kush është mëkati më i madh?" Është përgjigjur: "Të kërkojë ndihmë nga dikush tjetër pos All-llahut, kurse Ai të ka krijuar". (Buhariu)

(1) Apo, siç njihen në Turqi e po ashtu edhe në Kosovë, Shqipëri e më gjerë, Xhemati i Nurxhive.

(2) Said Nursi është quajtur Bediuzzaman/"Mrekulli e kohës".

(3) Faqja zyrtare e tyre e internetit në gjuhën e shqipe albnur.com dhe "Nurcuya nasihat" nga autori Ebu Muaz Seyfullah Erdoğan/Çubukâbâd/ANKARA 05.05.2005.

(4) Albnur.com, Bediuzzaman Said Nursi -I-.

(5) Ibid.

(6) Ibid.

(7) Şualar, Sözlür Yayinevi, İstanbul. 1993, Fq. 617.

(8) Bediuzzaman Said Nursî, Tarihçe-i Hayat, Sözlür Yayinevi, İstanbul 1991, fq.34.

(9) Bediuzzaman Said Nursî, Haşiye, Tarihçe-i Hayat, Fq. 33.

(10) Tarihçe-i Hayatı, Fq. 45.

(11) Nurcuya Nasihat-nga autori Ebu Muaz Seyfullah Erdoğan/Çubukâbâd/ANKARA 05.05.2005.

(12) Mektubat Geylani-onun mektuplari, bahar yayinlari, fq.5.

Grupimet e Nurxhive

Nurxhitë janë të ndarë në disa grupe. Prej tyre është një grup që pasojnë Fet'hullah Gylenin¹³, të tjerët quhen *okujuxhullar* (d.m.th. lexuesit e "Risale-i Nurit"), *jazëxhëllar* (ata të cilët shkruajnë), mirëpo të gjithë e kanë si shejh të tyre Said Nursin.¹⁴

Ka thënë Said Nursi në "Sözlür" **15**:

"Pa dyshim, "Sözlür" është nga nuri i shndritshëm i Kur'anit. Pa pasur nevojë për shpjegim në përgjithësi, është i tëri pa të meta dhe i përkryer".¹⁶

Zaten, kjo shihet qartë nga pasuesit e tij që e kanë lënë anash leximin e Kur'anit dhe merren më shumë me "Risale-i Nur", saqë ka prej tyre që njihen si hafizler të "Risale-i Nurit".

Të tjera aspekte të devijimit të tyre

Vetë Said Nursi i thërret njerëzit tek librat e tij, duke pretenduar se librat e tij janë pa të meta dhe të përkryera.

Thotë Said Nursi:

“Risale-i Nur në këtë shekull, në këtë kohë, është *“Urvet’ul Vuthka”*, që do të thotë shumë i besueshëm, me zinxhirë të pashkëputur, dhe *“Hablullah”*, që do të thotë litar i All-llahut... është i shpëtuar ai që kapet për të”.¹⁷

“Urvetul Vuthka” dhe *“Hablilah”* janë nga veçoritë e Kur’anit fisnik.¹⁸ Pra, Said Nursi veprës së vet ia atribuon veçoritë e Kur’anit.

Në një vend tjetër, pëshpërit Said Nursi:

“Risale-i Nur nuk është marrë as nga kultura dhe dituria e Lindjes e as nga filozofia e Perëndimit, si një dritë e huazuar. Ai është nga qielli që është zbritur Kur’ani, mbi lindjen dhe mbi perëndimin, ku gjendet Arshi. Është huazuar nga vendi i Arshit”.¹⁹

Thotë All-llahu subhanehu ve teala:

“Është shkatërrim për ata që me duart e veta e shkruajnë librin e pastaj thonë: “Ky është prej All-llahut!”, për të arritur me të një fitim të paktë. Pra, është shkatërrim i madh për ta çka shkruan duart e tyre dhe është shkatërrim i madh për ta ajo çka fitojnë.” (el-Bekare, 79)

(13) Fet’hullah Gyleni është njëri ndër prijësit më të respektuar të Nurxhive sufistë. Ai u ndihmon xhematit të tyre me hapjen e shkollave, botimin e librave, revistave dhe mbajtjen e koncerteve. Fet’hullah Gyleni jeton në Pensilvani (Amerikë) dhe e ka të ndaluar hyrjen në Turqi. Xhemati i tij e ka hapur kolegjin “Mehmet Akif Ersoj” në Kosovë.

(14) Për momentin, në Kosovë vepron shoqata e tyre me emrin “Atmosfera”. Po ashtu, kanë hapur kolegje të ndryshme. Njëri prej hoxhallarëve, për fat të keq, është shqipfolës dhe ka thënë se tefsir më i përsosur se i Said Nursit nuk ekziston. Subhanallah! Ku është tefsiri i Ibn Abbasit?!, për të cilin pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, bëri du’a: “O All-llah, udhëzoje në fenë e vërtetë!” (Buhârî, Libri Abdestit, Hadithi numër: 143), dhe në një transmetim tjetër: “O All-llah, mësoja urtësinë”. (Buhariu, Hadithi numër 3756)

(15) Sözlür - kapitull në Risale-i Nur.

(16) Barla Lâhikası, faq. 26.

(17) Said Nursi, Şualar, Sözlür Yayınevi, İst. 1992, fq. 231.

(18) Lexo el-Bekare, 256, dhe Ali-Imran, 103, në lidhje me frazën e ajetit *“Urvetul vuthka”* dhe në ajetin tjetër *“Hablilah”*.

(19) Şualar, fq. 601

Në një vend tjetër, “Risale-i Nur” (Risale-Nur-Şualar) e komenton ajetin kështu:

“P.sh. fraza e ajetit 35 te sures Nur thotë: **“prej ullahit që nuk mund të quhet as i lindjes e as i perëndimit”**. Ndoshta është zbritur nga lartësitë e qiellit, nga thesari i rahmetit. Çdo vend është pasuri e Tij. Kërkimi në vende të tjera nuk ka nevojë. Risale-i Nur nuk është marrë as nga kultura dhe dituria e Lindjes e as nga filozofia e Perëndimit, por është si një dritë e huazuar. Ndoshta është huazuar nga vendi prej të cilit është zbritur Kur’ani.”

Në një ajet tjetër:

“Ata përpiqen me gojët e tyre ta shuajnë dritën (nurin) e All-llahut, e All-llahu nuk do tjetër pos ta përsosë dritën e Tij, ndonëse jobesimtarët e urrejnë.” (et-Tevbe, 32)

Qëllimi i shprehjes *“nur”* që gjendet në këtë ajet, argumenton për pejgamberllëkun e Muhammedit, sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem (Râzî, 1997: VI, 32) dhe për fenë e All-llahut (Taberî, 1995: VI/2, 149), ndërsa Said Nursi këtë ajet e komenton kinse ka të bëjë me *“Risale-i Nur”* (Lexo: Birinci Şua, fq.844.)

D.m.th. ajeti i lartshënuar, sipas komentimit të Said Nursit, në përkthim do të ishte:

“Ata përpiqen me gojët e tyre ta shuajnë dritën (Risale-i Nur) e All-llahut, por All-llahu nuk do tjetër pos ta përsosë dritën e Tij, ndonëse jobesimtarët e urrejnë.”

Në një ajet tjetër:

“Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat e i beson All-llahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. All-llahu është dëgjues i dijshtëm.” (el-Bekare, 256)

Said Nursi këtë ajet, nëpërmjet llogaritjes *Xhifra20* dhe *Ebxhed21*, pjesën e ajetit **“është kapur për lidhjen më të fortë”** e komenton se ka të bëjë me *“Risale-i Nurin”*.

D.m.th. kuptimi i ajetit sipas Said Nursit është kështu:

*“Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat e i beson All-llahut, ai është kapur për *“Risale-i Nur”* (lidhjen më të fortë), e cila nuk ka këputje. All-llahu është dëgjues, i dijshtëm.”*

Kurse, në fakt, fraza e ajetit **“lidhjen më të fortë”** ka të bëjë me imanin (Taberî, III/1, 29), me Islamin, se nuk ka Zot tjetër që meriton të adhurohet përpos All-llahut (Kurtubî, II/1, 257).

Ja edhe fjalët në faqen 837 të Birinci Şua-Risale-i Nur:

“Edhe në suren el-Bekare ajeti 256, edhe në suren Lokman ajeti **“është kapur për lidhjen më të fortë”**... sipas llogaritjes *xhifr* të ajetit *“Urvetil vuthka”*, është nxjerrë numri 1347, dhe ky numër ka të bëjë me vitin e shkëlqimit të Risale-i Nur ...”

Në faqen 834 të Birinci Şua-Risale-i Nur, thuhet:

“Në suren Hud është një ajet i njohur (ajeti 105), i cili i jep dy shenja të fuqishme. Nëpërmjet llogarisë *Xhifr*, është nxjerrë numri 1303. Po ashtu në suren Shura, në faqen e dytë, në ajetin ku bie numri 1309, pra, kjo datë ka të bëjë me një thirrës në çështjen e llogarisë së Kur’anit... data e parë ka të bëjë me shkrimin e Risale-i Nur... ndërsa shenja e ajetit të dytë ka të bëjë me përfitimin e diturisë së tij për një kohë shumë të shkurtër”.

Sipas Said Nursit, ajeti **“Thuaj: “Vërtet Zoti im më udhëzoi në rrugë të drejtë”** (el-En'aam, 161) ka të bëjë me datën e përgatitjes së “Risale-i Nurit”.

Kjo vërtetohet nga vepra e tij Birinci Şua-Risale-i Nur, në faqen 836:

“Ajeti **“Vërtet Zoti im më udhëzoi në rrugë të drejtë”** (el-En'aam, 161), në bazë të shifrës/llogarisë *xhifr* që është nxjerrë nga shkronjat e këtij ajeti, tregon në numrin 1316, gjë që bie në të njëjtën datë me përgatitjen e Risale-i Nur.”

Nurxhitë, pos këtyre gabimeve djallëzore që i cekëm më lart nga libri bazë i tyre “Risale-i Nur”, shpikën edhe lloje të ndryshme të dhikrit, që i bëjnë pas pesë kohëve të namazeve, duke filluar së pari me *salatel tunxhinën*, pastaj dhikrin e ligjëruar e pas kësaj me disa du'a që nuk janë të argumentuara me shariat, dhe së fundi me përmendjen e disa emrave të All-llahut, si p.sh Ja Xhemilu, ja All-llah; ja Karibu, ja All-llah; ja Muxhibu, ja All-llah; ja Habibu, ja All-llah... dhe e përfundojnë me ajetin 27-29 të sures Fet'h.22

Është pyetur shejhul Islam Ibn Tejmije (rahimehullah): A është e lejueshme shpikja e llojeve dhe stileve të dhikrit?

Përgjigje: Pa dyshim që dhikret dhe lutjet janë midis formave më të mira të adhurimit, dhe adhurimi është një nga çështjet në të cilat s'ka vend për opinione personale. Ne duhet të ndjekim atë çfarë bëri dhe mësoi peygamberi (salallahu alejhi ue selam), jo tekat dhe dëshirat apo risitë/bidatet. Lutjet dhe dhikret e peygamberit (salallahu alejhi ue selam) janë më të mirat që njeriu mund të gjejë. Ai që ndjek në këtë mënyrë, do të jetë i sigurt, dhe dobitë e rezultatet pozitive që ai do t'i fitojë janë përtej përshkrimeve. Çfarëdo tjetër lutje dhe dhikër mund të jetë haram apo mekruh (e urryer). Ajo mund të përfshijë shirk, ndonëse shumica e njerëzve nuk e kuptojnë këtë – Hollësitat e kësaj do të zgjasnin tepër po të shpjgoheshin këtu. Askush s'ka të drejtë t'i mësojë njerëzit me ndonjë lloj lutjeje apo dhikri veç atyre që janë përmendur në Sunet, apo ta bëjë atë adhurim të rregullt për të cilin ai pret që njerëzit ta bëjnë rregullisht si pesë namazet ditore. Kjo është risi në fe (bidat), të cilën Allahu nuk e lejon... Për sa i përket bërjes së

çuditshme të dhikrit rregullisht, kjo s'është parashkruar në shariat dhe është nga gjërat që s'janë të lejueshme. Lutja dhe dhikri i parashkruar në Sheriat janë më të mirat që dikush ka shpresuar të gjejë, dhe askush nuk i injoron ato në favor të dhikrit të shpikur, përveç atij që është i paditur, i shkujdesur apo keqbërës".²³

Andaj, vëllezër dhe motra, kini kujdes nga këto xhemate dhe mos pasoni të dyshimtat, duke u bazuar në pohimin se çfarëdo që gjendet në këto libra nga e vërteta, e marrim, ndërsa çfarëdo që është e pavërtetë, nuk e pranojmë. Ky pohim është hedhur poshtë nga imamët e hadithit, të kaluarit dhe të sotshmit. Për fat të keq, këto thënie i dëgjojmë nga ata të cilët pretendojnë se thërrasin në sefillëk, mirëpo sefillëku është në një anë e ata janë në anën tjetër.

Shejh Ahmed Bazmul shkruan në biografinë e shejhut të tij, el-Muhadith, es-Selefi, Jahja bin Uthman Athim Abadi el-Hindi el-Meki, rahimehullah:

"E pyeta lidhur me thënien: 'Në një libër mund të ketë edhe dobi?'"

Ai u përgjigj: "Këtë thënie s'duhet marrë përgjithësisht. Nëse ai që e lexon është i rrënjosur thellë në akide dhe në dituri, atëherë s'prish punë. Për sa i përket fillestarit, ai duhet të përmbahet nga leximi i këtyre librave, siç janë librat e logjikës, Sufizmit, të bidatçinjëve si Dahlan dhe librat që janë përplot rrëfenja të Israilitëve, si *Bedai' ez-Zuhur* dhe *Tenbihul Ghafilin* të es-Samarkandi".

Dhe Shejhul-Islam Ibn Tejmije ka thënë: "Është e urryer që ai i cili s'ka aftësi për të kritikuar dhe për të bërë dallim (mes të vërtetës dhe pavërtetësisë), t'i lexojë këto libra që përmbajnë disa transmetime të shpikura dhe opinione çorientuese, si librat e njerëzve të bidatit. Dhe është e urryer që të merret dituri nga *kassaa*s (tregimtarët) dhe të ngjashmit me ta, të cilët gënjejnë shumë kur flasin, edhe nëse shumë nga ajo që flasin është e vërtetë". (Fund i citatit. Shiko *en-Nexhm el-Bedi*, f.27)

Mbetet një pyetje që ka nevojë për përgjigje, dhe ajo është: Cili është shtegu për në shpëtim nga këto libra, që të shpëtohen njerëzit e Sunetit prej tyre?

Shtegu është ndjekja e mënyrës/rrugës së Selefus Salih në trajtimet që u kanë bërë librave të njerëzve të tekave dhe bidateve. Mënyra e tyre ishte paralajmërimi kundër këtyre librave dhe lënia e leximit të tyre, si dhe paralajmërimi kundër autorëve të tyre. Madje, ata udhëhoqën me detyrimin e shkatërrimit të këtyre librave dhe djegien e tyre.²⁴

I dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka paralajmëruar kundër leximit të shkrimeve të Njerëzve të Librit, ndonëse tek ata gjendet diçka nga e vërteta.

Nga Xhabir bin Abdullah, i cili tha se Umer bin el-Hatab erdhi tek pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) me një shkrim, të cilin e kishte marrë nga Njerëzit e Librit, kurse ai

(salallahu alejhi ue selam) u hidhëruar dhe tha: "A mos po dyshon, o Ibn el-Hatab?! Pasha Atë, në dorën e të cilit është shpirti im, unë ju kam ardhur me atë që është e qartë. Mos i pyetni ata për ndonjë gjë, se ata mund të thonë të vërtetën e ju ta mohoni, apo mund të thonë të pavërtetën e ju të besoni në të. Dhe pasha Atë, në dorën e të cilit është shpirti im, po të ishte gjallë Musai, do t'i duhej të më ndiqte".**25,26**

Kjo do të ishte e tëra për vëllezërit dhe motrat e mia shqipfolës, edhe pse këto gabime që janë shkëputur nga librat e tyre janë si një pikë e ujit e nxjerrë nga deti, meqë ka shumë gabime të tjera të cilat unë nuk i kam cekur. Mirëpo, inshAll-llahu teala kjo do të mjaftojë për ata që dëshirojnë ta dinë hakkun. E kam pasur paksa të vështirë ta përpiloja këtë punim, pasi që libri "Risale-i Nur" është shkruar në gjuhën osmane. Dhe, së pari, e falënderoj All-llahun që ma mundësoi ta përfundoja këtë punim të varfër timin para syve të njerëzve, por, inshallah, të madh tek All-llahu subhanehu ve teala. Pastaj vlen të theksohet edhe një falënderim ndaj një vëllai tonë selefi, i cili e njuh gjuhen turke dhe më ndihmoi paksa në përkthim të fjalëve origjinale nga "Risale-i Nur".

Falënderimet i takojnë All-llahut, dhe paqja e shpëtimit i All-llahut qofshin mbi të Dërguarin e All-llahut, sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem.

(20) Metoda të ndryshme mbi njoftimin e ngjarjeve që do të ndodhin. Këtë metodë e kanë përdorur Kaldeanët, Asirianët, Babilonasit, Egjiptianët dhe më vonë çifutët e magjistarët që jetuan në mesin e të krishterëve dhe disa mistikë. (Nurcuya Nasihat nga autori Ebu Muaz Seyfullah Erdoğmuş/Çubukâbâd/ANKARA 05.05.2005)

(21) Në bazë të shkronjave të Kur'anit, si p.sh. elif, lam, mimë, etj, janë munduar të nxjerrin numra për histori/ngjarje me data të ndryshme. (Büyük Türkçe Sözlük Dr.Mehmet Doğan-Yeni Şafak, fq.317)

(22) Më gjerësisht rreth llojeve të shpikura të dhikrit të Nurxhive mund të gjeni në librin, siç e quajnë ata, "Xhevshen", Tesbihat ve Cevsen (transkripsiyonlu), Hazirlayan Kenan, Demirtas, Subat 2004, Nesil yayinlari.

(23) *Mexhmu el-Fetaua*, 22/510-511 e shejhul-Islam Ibn Tejmije.

(24) Janë përkthyer në gjuhën shqipe libra nga Said Nursi, nga Fet'hullah Gyleni dhe është hapur faqja e tyre e internetit albnur.com.

(25) Mbledhur nga imam Ahmed (3/387), ed-Darimi (1/115), dhe është cilësuar Hasen nga Muhadith el-Albani në *Irua* (6/338-340).

(26) www.mbueroja.net

Përgatitur nga Ebu UNEJS
Prizren 1428/2007